



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 309 Nr. ifaq/Br. nr./No pg 01

Data/Datum/Date 29/04/2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2022 merr këtë:

## V E N D I M

### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1863/22 i datës 08.04.2022 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekura në pikën 1 të këtij propozimi janë:
  - 2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510008-00054-0 në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, në vendin e quajtur Seoska shuma-krajshte, me kulturë Kullosë e Klasës 6, në sipërfaqe të përgjithshme prej 256m<sup>2</sup> (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
  - 2.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510008-00265-0 në zënën kadastrale Hoçë e Madhe, në vendin e quajtur Krilinski dubovi, me kulturë Mal e Klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 855m<sup>2</sup> (tetëqind e pesëdhjetë e pesë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
  - 2.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-00498-0 në zënën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Brinja, me kulturë Kullosë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4487m<sup>2</sup> (katërmijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
  - 2.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02909-0 në zënën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Kuqishte, me kulturë Kullosë e Klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4510m<sup>2</sup> (katërmijë e pesëqind e dhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
  - 2.5. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-03015-0 në zënën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Seljane, me kulturë Arë e Klasës 6, në sipërfaqe të

përgjithshme prej 290m<sup>2</sup> (dyqind e nëntëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

2.6. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-03016-0 në zënën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur Seljane, me kulturë Vreshtë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 650m<sup>2</sup> (gjashtëqind e pesëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

2.7. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-715100251-00251-0 në zënën kadastrale Çifllak, në vendin e quajtur Mala-shuma, me kulturë Mal e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 114230m<sup>2</sup> (njëqind e katërbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 100000m<sup>2</sup> (njëqindmijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe dhënia e mundësisë qytetarëve për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) vite.
5. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

11. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.309/22**  
**Me datë:29.04.2022**

